



Sfidat e sigurisë njerëzore në Kosovë

Autori: Besa Kabashi-Ramaj



Centre for
Research

Documentation
and Publication

**FRIEDRICH
EBERT** 
STIFTUNG

Destabiliteti politik në Kosovë dhe implikimet për sigurinë njerëzore të popullatës

Titulli: Sfidat e sigurisë njerëzore në Kosovë: Destabiliteti politik në Kosovë dhe implikimet për

sigurinë njerëzore të popullatës

Autorë: Besa Kabashi-Ramaj;

Përkthyer nga: Artan Sadiku;

Redaktuar nga: Artan Sadiku;

Viti i botimit: Korrik, 2017;

Botuar nga: Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (QHDP)

Rr. Garibaldi, Hyrja 2, Nr. 17, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës; Tel: +377 45 321 545; info@crdp-ks.org; www.crdp-ks.org.

Tirazhi i ekzemplarëve të botuar: 100

Title: Human Security challenges in Kosovo: Political Instability in Kosovo and Implications for the Human Security of the People

Author: Besa Kabashi-Ramaj;

Translated by: Artan Sadiku;

Editor: Artan Sadiku;

Published: July, 2017;

Published by: Centre for Research, Documentation and Publication (CRDP); Str. Garibaldi, Entrance 2, No.17, Prishtine, 10000, Republic of Kosovo; Tel: +377 45 321 545; info@crdp-ks.org; www.crdp-ks.org

Circulation published: 100

July, 2017
Prishtine, Republic of Kosovo

Ky projekt u përkrah nga
Friedrich Ebert Stiftung

Përmbajtja e këtij publikimi pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e autorëve që janë përgjegjës për faktimin dhe saktësinë e të dhënave të prezentuara këtu. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, jo domosdoshmërisht i paraqesin ato të Friedrich Ebert Stiftung.

The content of this publication reflects the views and opinions of the authors, who are responsible for the facts and accuracy of the data present herein. The views and opinions expressed here do not necessarily represent those of Friedrich Ebert Stiftung.

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	7
II. Fajtori për progresin e ngadalshëm: Historia e "zgjedhjeve të hershme" dhe "mospërfundimi i mandateve qeveritare"	7
III. Kosovarët dhe gjendja e sigurisë humane	10
IV. Si mund të jetë më e mirë Qeveria e Kosovës?	13
Referencat	14

I. Hyrje

Janë bërë shumë hulumtime dhe shkrime mbi sfidat dhe mundësitë e zhvillimit të mëtejshëm të Kosovës si shtet, ekonomi dhe shoqëri. Është i njohur fakti se politikat ekonomike të vendit janë orientuar kryesisht drejt qëndrueshmërisë së sektorit publik, një sektor mjaft i madh e për këtë arsye edhe i kushtueshëm. Për më tepër, janë mirë të dokumentuara sfidat që ka Kosova me informalitetin, korrupsionin, burokracinë dhe paqëndrueshmërinë politike, të cilat kontribuojnë në dekurajimin e investimeve të huaja. Si rezultat, Kosova ballafaqohet me kufizimet e vizave të imponuara nga BE, të cilat e kanë vënë popullatën e Kosovës në një mjedis të getoizuar (Global Security, 2017). Pa dyshim, siguria humane në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Kosova) është larg nga ku duhet të jetë (Coleman, Siguria njerëzore në Kosovë: ana tjetër e sigurisë kombëtare?, 2016). Ndonëse shumë faktorë kanë kontribuar në përparimin e ngadalshëm në Kosovë për dhjetë vitet e fundit dhe gjendjen e sigurisë njerëzore të qytetarëve të saj, një çështje qendrore (dhe shpesh e anashkaluar) ka qenë jostabiliteti politik, duke përfshirë zgjedhjet vazhdimisht të parakohshme që rezultojnë në një seri mandatesh të papërfunduara të qeverisë. Si pasojë, implikimet për sigurinë njerëzore kanë qenë të thella, pasi harresa në të cilën e mban paqëndrueshmëria politike përparimin e Kosovës vetëm se ka ushqyer më shumë sfida, në mes tjerash: sigurinë e ushqimit, sigurinë e punës dhe sigurinë shëndetësore.

II. Fajtori për progresin e ngadalshëm: Historia e "zgjedhjeve të hershme" dhe "mospërfundimi i mandateve qeveritare"

Kosova ka bërë një rrugë të gjatë që nga lufta e vitit 1999. Faza e gjatë e tranzicionit nga mbajtja e paqes në ndërtimin e paqes në shtetndërtim ka nxjerr tashmë frytet e saj, një konflikt që është mbajtur në të kaluarën dhe një Kosovë relativisht stabile. Kosova tashmë ka bërë përparim të dukshëm politik. Republika e Kosovës është njohur nga 113 shtete anëtare të OKB-së (Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, 2017). Së dyti, Kosova ka bërë shumë përparim sa i përket konsolidimit të shumicës së institucioneve të saj shtetërore. Së treti, përparim është bërë edhe sa i përket zhvillimit ekonomik të Kosovës (Coleman, Siguria njerëzore në Kosovë: ana tjetër e sigurisë kombëtare, 2016).

Në hulumtimin e bërë nga Alesiza, Ozler, Rubini dhe Swagel (1996), paqëndrueshmëria politike është përcaktuar si "prirje e një kolapsi të qeverisë ... një model në të cilin bashkërisht përcaktohet një masë e tillë e paqëndrueshmërisë politike dhe rritjes ekonomike". Rezultatet e hulumtimit të tyre tregojnë se përderisa rritja e ulët ekonomike rrit shansin për ndryshime qeveritare, paqëndrueshmëria politike dhe kolapsi pasues i qeverisë rrit mundësinë për bllokimet e ardhshme të qeverisë (Alesina, Ozler, Rubini, & Swagel, 1996).

Që nga pavarësia e Kosovës, sfera politike ka qenë e rrënuar nga ndarja, madje edhe kur kanë qenë në pyetje interesat kombëtare kritike dhe në këtë kuptim, e ardhmja duket e pasigurt për popullatën, e cila ka nevojë aq të

madhe për një vend të unifikuar, të mbledhur rreth nevojave shumë të mëdha të qytetarëve. Siç është momentalisht, Kosova ende merret me pamundësinë për të përmbushur nevojat themelore të qytetarëve të saj, siç u përmend më lart. Për më tepër, Kosovës ende i mbetet të tejkalojë pengesën kryesore për progres, korrupsionin dhe krimin e organizuar, si dhe gjithashtu të jetë në gjendje të nxjerrë në një farë mënyre mundësitë reale të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etnike apo edhe të synojë pajtimin por në një mënyrë kuptimplote. Megjithatë, qeveritë vazhdimisht të paqëndrueshme dhe ajo që tani është bërë traditë, zgjedhjet e parakohshme janë një ndërprerës i madh i progresit në çdo fushë të përmendur më lart (Global Security, 2017).

Qeveria që rezultoi nga zgjedhjet kombëtare të 17 nëntorit 2007, mandati i saj u ndërpre menjëherë pas pavarësisë. Mandati i kësaj qeverie u ndërpre kur, pas pavarësisë, Kosova mbajti zgjedhjet e veta kombëtare më 15 nëntor 2009. Rrjedhimisht, për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për Presidentin Sejdiu duke përmendur shkeljen e "kushtetutës për mbajtjen në të njëjtën kohë të pozitës së presidentit dhe kryetarit të partisë së tij politike, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)" dhe dorëheqjen e 27 shtatorit të Presidentit Sejdiu, krijoi një efekt zinxhiror që përkeqësoi marrëdhëniet e koalicionit qeverisës midis LDK-së dhe PDK-së (Partia Demokratike e Kosovës), ku edhe një herë rezultat ishin zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Me votimin e Kuvendit të Kosovës për mosbesim ndaj Qeverisë Thaçi, zgjedhjet e parakohshme ndodhën edhe më 12 dhjetor 2010. Ndërsa komuniteti ndërkombëtarë / vëzhguesit i quajtën zgjedhjet efektive, në nivel lokal zgjedhjet ishin skandalizuar nga parregullsitë dhe manipulimet elektorale, parregullsitë në numërim, frikësimet dhe

presioni i vëzhguesve lokalë, thyerjet e procedurave zgjedhore, falsifikimi i nënshkrimeve në listën e votuesve dhe votimi familjar, të cilat çuan në rivotim në disa komuna në fillim të vitit 2011 (Global Security, 2017).

Rezultatet përfundimtare nga këto zgjedhje u certifikuan më 7 shkurt 2011 dhe pas negociatave të ndërsjella u krijua një qeveri e re koalicioni, të formuar nga Hashim Thaçi në koalicion me AKR-në, pakicat dhe "Listën Rugova". Marrëveshja e koalicionit e bëri Behgjet Pacollin president të ri dhe qeveria e koalicionit të ri u kryesua nga kryeministri i atëhershëm Hashim Thaçi. Të gjitha të lartpërmendurat u vendosën më 22 shkurt 2011, por për shkak të ankesës së partive opozitare dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese që "zgjedhja e Kuvendit të Presidentit Pacolli shkeli kushtetutën sepse nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për të kryer votimin dhe për shkak të dështimit të sigurimit të më shumë se një kandidati për të kryer zgjedhjen". Kjo nënkuptonte se mandati i Pacollit do të përfundonte dhe u arrit një marrëveshje për kandidat konsensual vetëm deri më 7 prill 2011, Atifete Jahjagën. Marrëveshja u arrit në bazë të premtimit për reformën e rëndësishme zgjedhore e cila ende nuk ka ndodhur. Në tërësi, gjithë paqëndrueshmëria politike, duke llogaritur çmendurinë parazgjedhore, vlejti për një vit të tërë të pezullimit dhe stagnimit, për një vend që nuk mund t'ia lejojë vetes as edhe një ditë stagnimi (Global Security, 2017).

Zgjedhjet e parakohshme kombëtare të radhës u zhvilluan në vitin 2014, edhe një herë para se të përfundonte mandati katërvjeçar. Pas daljes së dy udhëheqësve të lartë nga PDK-ja, Fatmir Limaj dhe kryetarit të parlamentit Jakup Krasniqi, i cili njoftoi se po largoheshin nga PDK për të formuar një parti të re

(NISMA), koalicioni qeverisës filloi të bëhet vërtet i dobët dhe situata politike e paqëndrueshme. Si rezultat, edhe një herë, zgjedhjet e hershme kombëtare ndodhën më 8 qershor 2014, pas së cilës partia fituese PDK-ja, nuk mundi të formonte shumicën parlamentare, gjë që çoi në një bllokadë politike. Në të njëjtën kohë, partitë e opozitës, LDK që u rendit e dyta në zgjedhje, Vetëvendosja (VV), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe NISMA formuan një koalicion kundërshtar me synimin për të formuar qeverinë. Ajo që rezultoi ishte një veprim i paparë që çoi në një koalicion qeverisës të dobët dhe të trazuar. LDK-ja u nda nga koalicioni opozitar dhe u bashkua me PDK-në për të formuar qeverinë. Kjo çoi në një tjetër mandat shumë të shkurtër të qeverisë, i rrënuar nga një opozitë shumë aktive dhe madje edhe të dhunshme, dhe një kuvend jofunksional që nuk mund të kalonte ligjet dhe të merrte vendime me rëndësi vitale kombëtare.

Ngrirja politike që pasoi zgjedhjet e vitit 2014, së bashku me mungesën e një "epoke" shumë të pritshme politike në dritën e largimit të LDK-së nga koalicioni i opozitës, vetëm sa ushqeu edhe më tej dëshpërimin e një popullate të rraskapitur në aspektin shoqëror, e cila mund të diskutohet se ishte një nga shkaqet themelore të valës së emigrimit të vitit 2015. Këtu kemi përsëri një tjetër bllokim politik që e vuri të gjithë vendin në një bllokadë zhvillimore nga pranvera 2014 kur situata filloi të përkeqësohej, deri sa u formua një qeveri e re e që ndodhi në vjeshtë 2014. Ajo që pasoi ishte një tjetër qeveri koalicioni, e dobët dhe shumë e kontestuar, e cila do të sfidohej nga fillimi dhe kjo nuk mund të bënte shumë përsa i përket miratimit të vendimeve dhe ligjeve përmes procesit parlamentar. Ky mandat përfundoi gjithashtu në gjysmë të rrugës, me daljen e PDK-së nga koalicioni dhe votimi i mosbesimit në maj 2017, i

cili më pas çoi në zgjedhjet e parakohshme të 11 qershorit 2017 (Global Security, 2017).

Përkundër rezultateve të zgjedhjeve të fundit që janë premtuese për mënyrën se si duket se njerëzit votojnë ndryshe në krahasim me zgjedhjet e mëparshme dhe se si kjo do të mund të nënkuptonte qytetarin më të vetëdijshëm dhe më aktiv, të gatshëm të ndëshkonte zyrtarët e zgjedhur që nuk kanë përmbushur premtimet e tyre, pyetja mbetet, nëse qeveria e re do të krijohet aq shpejt sa të mos lejojë vazhdimin e ciklit vicioz të ngërçit politik dhe të stagnimit të gjerë të vendit.

Në fund mund të themi se, sa herë që Kosova ka paqëndrueshmëri politike, një tjetër qeveri jofunksionale, një tjetër grup zgjedhjesh të parakohëshme dhe një mandat i papërfunduar qeverisës, lënë pasojat të rënda për popullin e saj. Në të gjitha këto raste, populli i Kosovës vuan pasojat e: ndalimit të të gjitha punëve normale qeveritare; funksionimit shumë më të ngadalshëm të institucioneve shtetërore dhe institucioneve lokale; efektet pasuese të marrëdhënieve të jashtme që ngadalësohen si rezultat i një qeverie që nuk mund të marrë më shumë vendime ekzekutive, dhe përfundimisht, pasojat e humbjes së fondeve për shkak të pamundësisë për të marrë vendime ekzekutive sapo një mandat qeveritar të jetë ndërprerë e deri sa të formohet qeveria e re. Përveç kësaj mungesa e plotë e traditës së dorëzimit midis administratave, ku kemi administratën e re që fillon pothuajse nga zero, dhe rezultati është një humbje diku nga 3 deri në 6 muaj të punës normale të qeverisë derisa një qeveri e re të konsolidohet, apo ndoshta edhe deri në një vit shtesë, për ta thënë në mënyrë modeste, derisa qeveria e re t'i rrokë detyrat e tyre të reja dhe të jetë e vetëdijshme për sfidat dhe

si t'i zgjidhë ato, e që mund të kthehet në një vit e gjysmë stagnimi për çdo dy vjet "progres". Duke marrë parasysh sfidat me të cilat përballet Kosova dhe populli i saj, kjo nuk është vetëm negative, por edhe krejtësisht e dëmshme për përparimin e vendit dhe për përmirësimin e nevojave të sigurisë njerëzore të popullit të saj. Megjithatë, kjo që është bërë "mënyra e zakonshme e vendit" këto dhjetë vitet e fundit, është gjithashtu një dëshmi e mungesës së besnikërisë dhe përgjegjësisë së udhëheqësve politikë të Kosovës ndaj popullit të tyre, të cilët vuajnë nga veprimet e tyre në baza ditore.

III. Kosovarët dhe gjendja e sigurisë humane

Pavarësisht se paqëndrueshmëria politike e lartpërmendur është një emërues i përbashkët i sfidave të shumta të vendit sa i përket sigurisë së vet humane, institucionet dhe njerëzit në tërësi ende nuk kanë një kuptim të sigurisë përtej pikëpamjes tradicionale / realiste dhe për këtë arsye nuk janë duke pranuar korrelacionin e drejtpërdrejtë negativ që paqëndrueshmëria politike ka me sigurinë e tyre humane. Në këtë kuptim, institucionet e Kosovës dhe shoqëria në tërësi, mbajnë fokusin në çështjet e sigurisë që janë kryesisht të kuptimit tradicional, siç janë ushtria, policia dhe inteligjenca dhe janë më pak apo aspak të fokusuar në çështjet që lidhen me sigurinë njerëzore dhe atë shoqërore, po aq të rëndësishme për sigurinë kombëtare, veçanërisht për një vend të madhësisë së Kosovës. Koncepti i sigurisë njerëzore përfshin një numër faktorësh të ndryshëm, duke përfshirë sigurinë ekonomike, shëndetësore,

ushqimore, politike, komunitare, mjedisore dhe personale. Sipas Kofi Annanit (2001) *"Siguria njerëzore, në kuptimin e saj më të gjerë, përqafon shumë më tepër sesa mungesën e konfliktit të dhunshëm. Ajo përfshin të drejtat e njeriut, qeverisjen e mirë, qasjen në arsim dhe kujdesin shëndetësor dhe të siguruarit që secili individ ka mundësi dhe zgjedhje për të përmbushur potencialin e tij apo të saj. Çdo hap në këtë drejtim është gjithashtu një hap i madh drejt uljes së varfërisë, arritjes së rritjes ekonomike dhe parandalimit të konfliktit. Liria nga dëshira, liria nga frika dhe liria e gjeneratave të ardhshme për të trashëguar një mjedis të shëndetshëm natyror – këto janë blloqet e ndërlidhura që ndërtojnë sigurinë njerëzore – e rrjedhimisht edhe atë kombëtare."* (The Global Development Research Center, fq. 1). Ndonëse fokusi i sigurisë njerëzore ndryshon nga ai i sigurisë kombëtare, të dyja janë të lidhura ngushtë. Siguria njerëzore është shumë e rëndësishme jo vetëm për mirëqenien e vendit, por edhe për sigurinë kombëtare, stabilitetin dhe zhvillimin e përgjithshëm.

Pjesa më e madhe e fokusit në Kosovë në çështjet e sigurisë ka qenë përqendruar në krijimin e Forcës së Armatosur të Kosovës dhe parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Përqëndrimi vetëm në këto dy aspekte të sigurisë, ka lejuar shpërfilljen e çështjeve serioze themelore për sigurinë njerëzore dhe sigurinë shoqërore në vend, e të cilat nëse nuk trajtohet përbëjnë kërcënim serioz për sigurinë kombëtare në tërësi. Mungesa e rritjes ekonomike dhe mundësive për qytetarët e Kosovës është bërë sfidë serioze në konsolidimin e Kosovës si shtet i qëndrueshëm. Siguria kombëtare dhe qasja ndaj kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm deri më tani nuk ka arritur të adresojë një nga çështjet potenciale kryesore për Kosovën, kriza e identitetit të një popullsie kryesisht të re që është

mbingarkuar me informacion dhe ndryshim në një mjedis që nuk ka dhënë mbështetjen e duhur (Coleman, Siguria njerëzore në Kosovë: ana tjetër e sigurisë kombëtare?, 2016).

Përderisa qëllimi i një vendi të ri si Kosova duhet të jetë bërja e shtetit të aftë dhe të gatshëm për përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të veta ndaj qytetarëve të vet, Kosovës i mbeten ende mangësi të mëdha në fusha të ndryshme që lidhen me sigurinë njerëzore të qytetarëve të Kosovës. Këto mangësi i bëjnë qytetarët kosovarë edhe më të ndjeshëm, sidomos në një mjedis ku stabiliteti politik është në nivelin më të keq dhe ku zgjedhjet e parakohshme duket se pllakosin pothuajse çdo mandat të qeverisë, duke e bërë përparimin e Kosovës edhe më të papërshtatshëm.

Për të dhënë një pasqyrë më të qartë për gjendjen e qytetarëve kosovarë sa i përket sigurisë njerëzore, vlen të përmendim disa shembuj. Sipas një hulumtimi, qytetarët e Kosovës vuajnë *"nga mungesa e mundësive për punësim, mungesa e sigurisë së punës dhe mungesa e mjeteve financiare për të siguruar përmbushjen e nevojave të tyre bazë (ushqim, strehim, veshmbathje, qasje në arsim dhe kujdes shëndetësor, etj.)"* (Coleman, Siguria njerëzore në Kosovë: ana tjetër e sigurisë kombëtare?, 2016). Kërcënimet ndaj sigurisë ekonomike në Kosovë janë përkeqësuar edhe më tej. Përkundër përpjekjeve të fundit për përmirësime, duke shikuar gjendjen e kujdesit shëndetësor në Kosovë, hulumtimet tregojnë se ende ka shumë pengesa që shumica e qytetarëve përballen kur kanë nevojë për kujdes mjekësor. Shuma e lartë e kostos nga xhepi e kujdesit shëndetësor është një nga sfidat më dominuese. Qeveria e Kosovës ka dështuar në zbatimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, rreth 85% e qytetarëve

mbeten pa sigurim shëndetësor. Efektet më të rënda i vuajnë ata që tashmë janë në kufijtë e varfërisë, të cilët përfundojnë duke paguar për kostot e paparashikuara të kujdesit shëndetësor. Kjo, si rezultat ka efektin varfërues të më të varfërve. Kombinimi i kostos së lartë të kujdesit shëndetësor dhe sfidave të tjera në sigurimin e kujdesit të mjaftueshëm shëndetësor e bën popullin e Kosovës dhe Kosovën edhe më të rrezikuar. Një standard i ulët i shëndetit mund të lidhet me një ekonomi më të dobët dhe një popullsi që është më pak e aftë të ushtrojë të drejta të tjera kushtetuese (Coleman, Rekomandimet e politikave për kujdesin shëndetësor në Kosovë, 2016).

"Kostoja e lartë e kujdesit shëndetësor, sidomos për ata që janë më të prekur nga ekonomia e dobët dhe mungesa e mundësive për punësim, dobëson më tej popullsinë dhe ndikon negativisht në aftësinë e saj për të marrë pjesë në jetën politike, ekonomike apo shoqërore". Qeveria e Kosovës, duke pranuar nevojën për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e vet, ka ndërmarrë hapat fillestarë dhe ka miratuar Ligjin për Sigurimet Shëndetësore, por zbatimi i këtij ligji ka rezultuar i keqkoordinuar dhe ka stagnuar tërësisht; e qytetarët e Kosovës mbeten kryesisht të pasiguruar dhe vuajnë shërbimet e ulëta shëndetësore në përgjithësi, por sidomos në lidhje me aftësitë e diagnostikimit të hershëm. Përkundër kësaj, ka mungesë të debatit të rëndësishëm publik për përgjegjësinë e shtetit për të zgjidhur këto çështje menjëherë, dhe pasojat e mundshme të mosveprimit. Çështja e kujdesit shëndetësor nuk është shikuar nga prizmi i sigurisë humane dhe sigurisë shoqërore të qytetarëve të Kosovës apo rritjes së përgjithshme ekonomike të vendit (Coleman, Rekomandimet e politikave për kujdesin shëndetësor në Kosovë, 2016, Coleman, Siguria

njerëzore në Kosovë: Ana tjetër e sigurisë kombëtare?, 2016).

Kundërshtimi i ekstremizmit të dhunshëm është padyshim një detyrë vitale për vendet në mbarë botën, përfshirë Kosovën, e cila nuk ka qenë immune ndaj rreziqeve dhe pasojave të një kërcënimi të tillë. Megjithatë, qasja e ndërmarrë deri tani nga Kosova, pavarësisht nga shumë pika të forta në fushën e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm, ka pasur pengesa serioze në fushën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Kjo së pari ka ndodhur pjesërisht për faktin se si një vend i vogël në tranzicion, me institucione të reja, u përball me një problem kompleks dhe një kërcënim të ri dhe si i tillë duhej të mësonte duke vepruar (duke mësuar nga veprimet dhe gabimet). Së dyti, pengesat serioze kanë ndodhur për shkak të natyrës së mjedisit politik dhe mungesës faktike të stabilitetit politik. Që kur çështja e ekstremizmit të dhunshëm u ndez në publik dhe institucione gjatë vitit 2014, qeveria e re në vend, qeveria e koalicionit, u përball me faktin se ishte një koalicion i dobët dhe kishte një opozitë të madhe, duke përfunduar në trazira të vazhdueshme politike. Kjo rezultoi në shumë shpërqëndrime dhe humbje të fokusit nga ana e Qeverisë, gjë që më pas çoi në një strategji kombëtare më pak të harmonizuar se si të kundërshtojë radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Mungesa e një hartimi dhe zbatimi të harmonizuar dhe të koordinuar mirë të strategjisë nga fillimi, do të mundësonte që institucionet bartëse të luftimit të ekstremizmit të dhunshëm të jenë më të informuara dhe të përgatitura për të kryer aktivitete parandaluese, por fatkeqësisht kjo nuk ndodhi. Deri më tani, qasja e ndërmarrë ka qenë shumë më e fokusuar në aktivitetet e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe ka pasur mungesë të të kuptuarit të kompleksitetit të shkaqeve themelore jo vetëm të

radikalizimit, por sidomos kalimit në ekstremizmin e dhunshëm. Në këtë kuptim, një politikë e nivelit kombëtar për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm që nuk merr në konsideratë implikimet që mungesa e sigurisë njerëzore dhe sigurisë shoqërore mund të kenë në përpjekjet parandaluese dhe luftuese ndaj ekstremizmit të dhunshëm nuk është asgjë më pak sesa shkurtpamëse (Coleman, Siguria njerëzore në Kosovë: ana tjetër e sigurisë kombëtare?, 2016).

Të tre shembujt e mësipërm tregojnë një rëndësi të madhe për sigurinë njerëzore të Kosovës dhe për këtë arsye, për sigurinë e saj kombëtare. Sfidat e rëndësishme për sigurinë njerëzore shpeshherë nuk kanë marrë vëmendje të mjaftueshme, pasi fokusi i qeverisë së Kosovës dhe ai i bashkësisë ndërkombëtare ka qenë kryesisht duke synuar çështjet më të larta të sigurisë, nga një këndvështrim më tradicional dhe realist. Mos adresimi i nevojave themelore që kanë të bëjnë me sigurinë njerëzore dhe sigurinë shoqërore të qytetarëve të Kosovës ndikon në aftësinë e tyre për të siguruar të drejtat themelore të dhëna me kushtetutë, aftësinë e tyre për të qenë qytetarë aktivë dhe për të marrë pjesë në krijimin e ndryshimit që ata kanë nevojë, si dhe kontribuon në përforcimin e mëtejshëm të krizës tashmë të ndezur të identitetit. Kjo, nga ana tjetër, i bën qytetarët dhe shtetin të pambrojtur, qytetarët që nuk janë në gjendje të jetojnë jetë që i përmbush dhe shtetin të pa konsoliduar dhe të dobët, me siguri kombëtare shumë poroze.

IV. Si mund të jetë më e mirë Qeveria e Kosovës?

Për të qenë në gjendje të trajtojë sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova si vend dhe si popull, institucionet shtetërore dhe rrjedhimisht qeveria duhet të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme brenda mandatit të fituar, për të siguruar kohë të mjaftueshme për pranim-dorëzimin nga një qeveri e mëparshme, një fazë fillestare e të kuptuarit se ku janë duke u sfiduar sistemet në përmbushjen e nevojave të popullsisë, dhe pastaj të kenë kohën e mjaftueshme për të dhënë zgjidhje efektive. Mjerisht, kjo nuk ka ndodhur në Kosovë, që nga viti 2010 dhe padryshim edhe më herët, dhe kështu vazhdon akoma cikli i përhershëm me zgjedhjet e fundit dhe akoma edhe një bllokadë tjetër derisa të krijohet një qeveri e re. Prandaj, është e sigurt të thuhet se paqëndrueshmëria politike është terreni potencial i mbarështimit të mungesës së përgjithshme të kujtesës institucionale, vazhdimësisë dhe progresit, dhe për këtë arsye një terren potencial për një gjendje të përkeqësuar të sigurisë njerëzore dhe sigurisë shoqërore, që në fund të fundit kërcënon sigurinë kombëtare të Kosovës.

Ashtu si qeniet njerëzore, edhe shtetet duhet të përshtaten në mjedise të reja dhe të përshtaten me ndryshimet gjeostrategjike për të ruajtur veten. Kjo mund të nënkuptojë që fillimisht koncepti i sigurisë si tërësi duhet rishikuar dhe ripërcaktuar në mënyrë që të reflektojë botën siç është sot. Kjo gjithashtu mund të nënkuptojë që roli i shtetit duhet të shqyrtohet, në dritën e këtyre ndryshimeve. Ajo që sigurisht është e qartë, teorikisht dhe në praktikë, është se siguria kombëtare është e lidhur me sigurinë njerëzore dhe se për të ruajtur gjendjen e sigurisë kombëtare duhet

të mbrohet siguria njerëzore si dhe siguria shoqërore e popullatës. Kjo do të thotë se në fund të fundit, njerëzve që jetojnë brenda një shteti duhet t'iu sigurohet hapësirë dhe mjete për të përmbushur nevojat e tyre të sigurisë njerëzore, si dhe të ruhet identiteti i tyre etnik, kulturor, fetar dhe kombëtar, si një mënyrë për të ruajtur sigurinë kombëtare. Në këtë kuptim, përgjegjësia për sigurimin e një hapësire dhe mjetesh të tilla bie mbi udhëheqësit politikë në vend, përgjegjësia përfundimtare e të cilëve si zyrtarë të zgjedhur duhet të jetë kujdesja për nevojat e popullsisë që ata janë zgjedhur ta përfaqësojnë. Për më tepër, edhe vendimet e tyre politike duhet të bazohen në përcaktimin e prioriteteve të duhura, duke filluar me mënyrën se si vendimet e tyre politike do të ndikojnë tek njerëzit për të cilët ata kanë për qëllim të përfaqësojnë, para se të mendohet se si do të ndikojnë në axhendat e tyre politike. Vetëm duke ndryshuar mendësinë që ndryshon nga mënyra se si funksionojnë udhëheqësit politikë kosovarë, nga një "figurë e partisë politike" tek një "burrështetas" i cili është i aftë të vendosë "popullin" në rend të parë, kur është e rëndësishme, mund të ndalet cikli vicioz i paqëndrueshmërisë politike dhe stagnimit.

Mungesa e stabilitetit politik dhe si rrjedhojë e sigurisë njerëzore vë legjitimitetin e shteteve në rrezik të madh, duke dobësuar sigurinë kombëtare. Prandaj, cikli vicioz i paqëndrueshmërisë politike duhet të adresohet menjëherë si një mënyrë për të zhbllokuar "bllokadën e përparimit" dhe të jetë në gjendje të lejojë vendin të zhvillohet. Në këtë kuptim, është me rëndësi jetike të adoptohet gjithashtu një koncept i sigurisë që është më i përshtatshëm ndaj mjedisit aktual të sigurisë globale dhe që kombinon pikëpamjen tradicionale reale të sigurisë dhe rëndësinë e kërcënimeve ndaj shtetit, me një koncept më të gjerë të sotëm të sigurisë, ku merren parasysh

kërcënimet për popullin. Në këtë mënyrë, duke adresuar sigurinë njerëzore, përparësia më e madhe do t'u jepej njerëzve dhe mirëqenies së tyre, duke zvogëluar njëkohësisht një kërcënim të brendshëm ndaj shtetit, si agjenti primar në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke rritur mundësinë për stabilitet, paqe dhe rend. Megjithatë, asnjë nga të lartpërmendurat nuk mund as të fillojë të ndodhë pa stabilitetin e nevojshëm politik. Në këtë kuptim, është përgjegjësi e udhëheqësve politikë të Kosovës që në afat të shkurtër të fitojnë një mendësi që përqendrohet më shumë në atë që Kosova dhe populli i saj kanë nevojë në të vërtetë dhe çfarë është jetike për mbijetesën dhe vetëqëndrueshmërinë e këtij vendi, sesa interesi i partive politike të cilave ata i përkasin. Në afat të shkurtër, vetëm një vendim i vetëdijshëm për të zhvendosur mendësinë politike mund të thyjë ciklin vicioz të paqëndrueshmërisë politike që ka kapluar Kosovën.

Referencat

1. Alesina, A., Ozler, S., Rubini, N., & Swagel, P. (1996). Destabiliteti politik dhe rritja ekonomike. *Journal of Economic Growth*, 189–211.
2. Coleman, J. (2016). Siguria humane në Kosovë: Ana tjetër e sigurisë kombëtare? Prishtinë: Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim.
3. Coleman, J. (2016). Rekomandime mbi politikat shëndetësore në Kosovë. Prishtinë: Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim.
4. Global Security. (15 qershor 2017). Politika e Kosovës. Nxjerrur nga: GlobalSecurity.org: <http://www.globalsecurity.org/military/world/europe/ks-politics.htm>
5. Ministria e punëve të jashtme e Republikës së Kosovës. (2017). Njohjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Nxjerrur nga: Ministria e punëve të jashtme e Republikës së Kosovës: <http://www.mfa-ks.net/?page=2,224>
6. The Global Development Research Center. (n.d.). Definimet e sigurisë humane. Nxjerrur nga:

The

Global Development Research Center:

<https://www.gdrc.org/sustdev/husec/Definitions.pdf>



Str. Garibaldi, Entrance 2, no. 17, 10000 Prishtina, Republic of Kosovo
+377 45 321 545; +386 49 350 623 / info@crdp-ks.org



Sfidat e sigurisë njerëzore në Kosovë

Autori: Besa Kabashi-Ramaj

**FRIEDRICH
EBERT 
STIFTUNG**

Str. Garibaldi, Entrance 2, no. 17, 10000 Prishtina, Republic of Kosovo
+377 45 321 545; +386 49 350 623 / info@crdp-ks.org